

PËRPUNIMI I INSTITUCIONALIZUAR I TERMINOLOGJISË TEKNIKE

Gani PLLANA

Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

gani.pllana@uni-pr.edu

Sadete PLLANA

Universiteti i Prishtinës „Hasan Prishtina“, Fakulteti Ekonomik

sadete.pllana@uni-pr.edu

UDC 811.18'276.6

Professional paper

Abstract

To date Albanian terminology was studied in the form of special terminologies, starting from terminologies of more or less broad fields, like: economy, medicine, mechanics, agriculture and any other within them, such as agronomy, or even narrower. From terminologies of wider areas fundamental generalizations were achieved, but also from the narrower ones it was possible to undertake a thorough study of their specific issues. Partial generalizations discovered more detailed aspects of problems, especially specific aspects of synonyms, antonyms for specific areas, like for example, problems of polysemy for a limited field, when it appears as hybrid like the terminology of agricultural tools, the terminology of the field of mechanism theory etc.

In the conditions of the rapid development of technics and technology in recent years, the cooperation of the scientific-technical language with the standard Albanian language is continuing with a higher intensity than before. We notice a vigor of enrichment in the vocabulary of technical terminology, due to the birth and formation of new fields and subfields of technics, technology, as computing, mechatronics, telemetry, a multitude of concepts many of which, on the one hand, are marked with names of the languages they come from, mainly from English, but on the other hand, they meet their needs with the lexical mother tongue composition (by common words being raised to terms) and with the activation of other layers, such as compound word terms.

Thus, for example, in the field of computing, we notice in it the inclusion of the ordinary vocabulary for reproductive reasons, like *mi*, *dritare*, *flamur*, *adresë*, *skedar* (Engl: mouse, window, flag, address, file), and along with them, the compound word terms, serving

to differentiate relevant concepts, like, adresë e hiperlidhjes, adresë e uebit, adresë relative, adresë virtuale (Engl address hyperlink, web address, relative address, virtual address) etc.

On general terms, the technical vocabulary can be seen as a broad stratification consisting of units (one word or compound words) that functions and is identified in various fields of knowledge, limited by the knowledge and its use in ordinary discourse by speakers. In terms of the origin of its creation in the course of time to the present state it can be viewed also as a formation from common words, as well as in their further development, as units divided into two broad groups depending on their two transition stages from the forms of the special vocabulary: basal, to the forms of a higher special vocabulary, where, as a transition basis serves their elevation from a low concept to the high one.

Directly they relate as with common words, also with units of a higher conceptual level, as are terms, which we may call either special units of a scientific-technical level or specialized units, since they connect with specific identified knowledge fields. One of the direct methods of the standardization of terminology is the unification of terms in form and content from international terms. For the present time, the phenomenon of globalization is oriented mainly on this specialized lexical layer, and relates in a particular way with the flux of English words in it mainly in new areas of science.

Key words: *Technical vocabulary, special vocabulary, institutionalized processing*

Përmbledhje

Në kushtet e zhvillimit të hovshëm të teknikës dhe të teknologjisë këto vitet e fundit bashkëveprimi i gjuhës shkencore-teknike me gjuhën standarde shqipe po vijon me intensitet më të lartë se më parë. Vihet re një pasurim i vrullshëm i leksikut terminologjik teknik, për shkak të lindjes dhe formimit të fushave e nënfushave të reja të teknikës, të teknologjisë, si të kompjuteristikës, mekatronikës, telemetrisë, konceptet e shumta të të cilave, nga njëra anë, shënohen me emërtimet e gjuhëve nga vjen, kryesisht nga anglishtja, kurse, nga ana tjetër, ato i plotësojnë nevojat e tyre me brumin leksikor të gjuhës amtare (fjalët e zakonshme duke u ngritur në terma) dhe me aktivizimin e shtresave të tjera, siç janë termat togfjalësh.

Kështu, p.sh., në fushën e kompjuteristikës, vërehet futja në të e leksikut të zakonshëm riprodhues, si: **mi, dritare, flamur, adresë, skedar**, dhe krahas tyre, i termave togfjalësh, që shërbejnë për diferencimin e koncepteve përkatëse, si: **adresë e hiperlidhjes, adresë e uebit, adresë relative, adresë virtuale** etj. Deri më sot terminologjia shqipe është studiuar në formën e terminologjive të veçanta, duke filluar qysh nga terminologjitë e fushave pak a

shumë të gjera, si: ekonomia, mjekësia, mekanika, bujqësia dhe ndonjë tjetër brenda tyre, si p.sh. agronomia ose edhe më të ngushta.

Nga terminologjitë e fushave të gjëra janë arritur të bëhen përgjithësime themelore, por edhe nga të ngushtat është mundësuar thellimi i studimeve të ndërmarra, si çështje të veçanta të tyre. Përgjithësimet e pjesshme kanë zbuluar anë më të detajuara të problemeve, sidomos anë të veçanta të sinonimeve, antonimeve për fusha specifike, si p.sh. probleme të polisemisë për ndonjë fushë të kufizuar, kur ajo shfaqet si hibride, si terminologjia e veglave bujqësore, terminologjia e fushës së teorisë së mekanizmave etj.

Në kuptimin e përgjithshëm leksiku teknik mund të shihet si një shtresim i gjerë i përbërë njësisht (njëfjalëshe ose togfjalësha), që funksionon dhe që identifikohet në fusha të ndryshme të dijës i kufizuar nga ana e njohjes dhe e përdorimit të tij në ligjërim të zakonshëm nga folësit. Nga pikëpamja e zanafillës së krijimit të tij në rrjedhë të kohërave deri në gjendjen e sotme ai mund të vështrohet edhe si formim nga fjalë të zakonshme, si edhe në zhvillimin e tyre të mëtejshëm, si njësi që ndahen në dy grupime të mëdha në vartësi nga dy stade kalimi të tyre nga format e leksikut special: të ulët deri në forma të leksikut special të lartë, ku si bazë kalimi shërben ngritja e tyre nga një koncept i ulët në atë të lartë.

Drejtëpërdrejt ato lidhen si me fjalë të zakonshme, ashtu edhe me njësi të një niveli më të lartë konceptor, siç janë termat, të cilët mund t'i quajmë ose njësi speciale të nivelit shkencor-teknik ose njësi të specializuara, meqë lidhen me fusha të veçanta të identifikuar të dijës. Një nga mënyrat e drejtëpërdrejta të standardizimit të terminologjisë është njësimi i termave në formë dhe në përmbajtje prej termave ndërkombëtarë. Për ditët e sotme, dukuria e globalizmit orientohet kryesisht në këtë shtresë leksikore të specializuar, dhe lidhet në mënyrë të veçantë me vërshimin në të, të anglicizmave, kryesisht në fushat e reja të shkencës.

Fjalët kyçe: *Leksiku teknik, leksik special, përpunimi i institucionalizuar.*

Hyrje

Vija mbizotëruese në punën terminologjike teknike shqipe lidhet me përpunimin institucional (kolegjial) të saj, i cili është shprehje më e përqendruar dhe e drejtëpërdrejtë e zbatimit të idesë së planifikimit dhe politikës gjuhësore në terminologji (në konceptin e shkollës së Vjenës kjo specifikohet për terminologjinë edhe si "planifikim terminologjik")¹.

¹ K. Galinski, "Special Languages, Terminology Planning and Standardisation", Infoterm 2-86 en, 1986, f. 1.

Ky lloj përpunimi ka si qëllim kryesor realizimin e një varg detyrash si rregullimin e sistemit të terminologjisë dhe pasurimin me njësi nga brumi i shqipes.

Në realizimin e kësaj detyre bashkëpunojnë gjuhëtarët, terminologët, specialistët e fushës përkatëse edhe sot në raste të caktuara edhe informatikanët. Kjo punë në mënyrë ballësore ka filluar në Shqipëri me krijimin e kushteve materiale, ekonomike, politike e shoqërore, që është konkretizuar me ngritjen e institucioneve të specializuara për terminologjinë si edhe me planifikim fondesh, mjetesh etj. Mbi këtë bazë ka funksionuar në Shqipëri sektori i terminologjisë (qysh nga viti 1955) në IGJL në ASHSH.

Në Kosovë kjo veprimtari është zhvilluar brenda Institutit të Albanologjisë. Në Shqipëri me punën e zhvilluar mbi bazën e komisioneve të përbëra nga gjuhëtarë, terminologë e specialistë vetëm brenda viteve 60-70 janë përpunuar rreth 15 fusha themelore të dijes (botanikës, matematikës, kimisë, ndërtimit etj.) dhe janë botuar fjalorët përkatës. Këta fjalorë janë ribotuar në Kosovë duke iu shtuar gjuha serbo-kroate (1969-1973). Deri më sot, në Shqipëri, janë botuar rreth 36 fjalorë me mbi 70.000 terma. Një sasi e madhe fjalorësh terminologjikë janë hartuar e botuar edhe nga Akademia Ushtarake e Shqipërisë me mbi 100.000-200.000 terma.

Rezultatet e përpunimit institucional (kolegjial) të terminologjive

Rezultatet e përpunimit institucional (kolegjial) të terminologjive janë konkretizuar në përfshirjen sidomos të termave shqip në fjalorët e shumtë terminologjikë, si edhe në tekstet mësimore të shkollës 8-vjeçare e të mesme, dhe më vonë edhe në shkollën e lartë, si: *tretës*, *tretësirë*, *trysni* etj. Megjithatë, duhet nënvizuar, se ndërmjet sasisë së madhe të termave të shqipëruar që kanë zënë vend në shumicën e këtyre fjalorëve terminologjikë dhe termave të huaj përkatës, barasvlerës së tyre, që qarkullojnë në përdorim, në tekste mësimore, në praktikën ligjërimore etj., është krijuar dhe vijon të ekzistojë një kontradiktë e thellë.

Kështu, p.sh., mund të thuhet se s'kanë gjetur përdorim një pjesë e madhe termash teknike të shqipëruar nga shumë fusha, si fusha e arkitekturës, minierave etj. Këtu po sjellim një varg shembujsh, të nxjerrë nga disa fjalorë të serisë (1-33) të fushave teknike, në të cilët numri i termave të shqipëruar që s'kanë gjetur e nuk po gjejnë ende përdorim. Në *kllopa* po i japim barasvlerësit e huaj që përdoren në vend të tyre ose edhe sinonimë shqip e që janë ngulitur në ligjërimin e shkruar e të folur:

Arkitekturë²

bregël-a (bankin/ë-a), *ballësor-i* (frontespici-i), *daltari-a* (skulptur/ë-a), *dasht-ër-a* (ankant-i), *drekor/e-ja, -et* (mens/ë-a, -at), *drithnik-u, -ët* (silos-i, -et), *flugëz-a, -at* (liste/ë-a), *frëngji-a, -ët* (mazgall-i, -at), *fushak-u, -ët* (tërthorëse), *hiptor-i, -ët* (ashensor-i), *kambcuer-i* (pedestal-i), *kr/ua-oi, -ojet* (shatërvan-i, -et), *kungë-a, -at* (absid/ë-a), *landëtar-i* (karpentier-i), *landëtinë-a* (ngrehin/ë-a), *lëm/ë-a* (shkall/ë-a) (shesh-i), *mazgall-i, -at* (frëngji-a, -të), *mbërtheckë-a, -at* (agrafe-ja), *pirg* (kullë), *thurë* (grilë), *treme* (hajati) etj.

Hidraulikë³

bashkëdikim-i (konfluencë), *blirim-i* (baticë+zbaticë), *brig/ël-la* (bankinë), *çelës uji* (saraçineskë-a), *dekantim-i* (kthjellim-i), *duq-i, -et* (rubinet-i), *gjerbim-i, et* (infiltrim-i), *gypëzim-i, -e* (tubacion-i, -e), *krua* (çezmë-a), *kullor/e-ja* (filtër-i), *përçojë-a* (kondukturë-a), *përplotësor-i* (kompensator-i), *rrjedhës-i* (fluid-i), *shpramj/e-a* (dezinfektim-i), *shtonë-a* (llagëm-i), *vandak-u, -ët* (fashinë-a), *ventil-i* (flegër-a) etj.

Elektroteknikë⁴

gjani (amplitudë), *kapëz-a* (born/ë-a, kapikord/ë-a), *kërthiz/ë-a* (rozet/ë-a), *ndërçelës-i* (komutator-i), *ndërçelj/e-a* (komutim-i), *ngritës-i* (lev/ë-a), *qymyr-i* (karbon-i), *tjetëror* (alternativ), *rregëtues* (pulsant), *thëngjill* (karbon-i), *van/ë-a* (kanal-i) etj.

Mekanikë⁵

brenë-a, -at (biell/ë-a, -at), *burgji-a* (vidhë-a), *çikrik-u* (argano-ja), *dorak-u, -ët* (manivel/ë-a, -at), *epj/e-a* (fleksion-i), *gardhim-i, -et* (barazhim-i), *grat-i* (rendiment-i), *jashtëqendërsi-a* (ekscentricitet-i), *kandar-i, -ët* (balancues-i, it), *lënd/ë-a* (substanc/ë-a), *lyrësim-i* (lubrifikim-i), *pejz/ë-a* (fibër-a), *prodhim-i, -et* (produkt-i, -et), *shtysë-a* (impuls-i), *strumbull-i* (aks-i), *zgjedhim* (rakordim) etj.

² *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E ARKITEKTURËS* (12) (shqip-serbokroatisht-rusisht-italisht-frëngjisht), RILINDJA Prishtinë, 1969.

³ *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E HIDRAULIKËS* (4) (shqip-serbokroatisht-rusisht-italisht-frëngjisht), RILINDJA, Prishtinë, 1973.

⁴ *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E ELEKTROTEKNIKËS* (9) (shqip-serbokroatisht-rusisht-italisht-frëngjisht), RILINDJA, Prishtinë, 1970.

⁵ *Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore TERMINOLOGJIA E MEKANIKËS* (8) (shqip-serbokroatisht-rusisht-italisht-frëngjisht), RILINDJA, Prishtinë, 1970.

Përfundim

Shkaqet e kësaj gjendjeje të terminologjisë janë komplekse (jashtëgjuhësore dhe brendagjuhësore) dhe kërkojnë të merren studime të veçanta të gjëra e të thella. Nga se thamë më lartë del se lënda e gjerë dhe e pasur, e përpunuar në mënyrë individuale dhe kolegjiale, me anët pozitive (pastrim, njësim, shqipërim të terminologjisë teknike) dhe me anët negative (që i përmendëm) krijon mundësinë për ta studiuar atë dhe për të nxjerrë përgjithësime me vlera duke përcaktuar edhe rrugët për përzgjedhjen e një pjese prej termave të shqipëruar, për t'i futur në përdorim: *hiptor* (ashensor) (mek., trnsp.), *thurë* (grilë) (nd.), *ndërçelës*, *ndërprerës* (el.) etj.

Kësaj kontradikte i duhen shtuar edhe zhvillimet kontradiktore të vërejtura pas viteve 90-të (në Shqipëri) dhe pas viteve 99-të (në Kosovë) në fushën e gjuhës në përgjithësi, të cilat pasqyrohen edhe në fushën e leksikut terminologjik, si parapëlqimi i termave të huaj, sidomos nga anglishtja (*fidbek*, *draft*, *menaxhim*, *menaxher*, *staf*) dhe rikthimi tek termat e huaj, dikur të shqipëruar, si: *dimension* (për përmasë), *solucion* (për tretës), *insufiçencë* (për pamjaftueshmëri), *ekuilibër* (për baraspeshë) etj.

Bibliografia

Duro, A.: "*Terminologjia si sistem*", PANTEON, Tiranë, 2001.

Baholli, B., & Nika, V.: "*Fjalor teknik frëngjisht-shqip: për degën mekanike dhe metalurgjike*", Universiteti i Tiranës, 1985.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 1. Terminologjia e botanikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht- frëngjisht). Prishtinë, 1970.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 2. Terminologjia e matematikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht- frëngjisht), Prishtinë, 1969.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 8. Terminologjia e mekanikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht- frëngjisht), Prishtinë, 1970.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 9. Terminologjia e elektronikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht), Prishtinë, 1970.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 12. Terminologjia e arkitekturës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht- frëngjisht), Prishtinë, 1969.

"*Fjalor i terminologjisë tekniko-shkencore 14. Terminologjia e hidraulikës*" (shqip-serbokroatisht-rusisht-frëngjisht), Prishtinë, 1973.

Pllana, G.; Pllana, S.: "*Gjendja dhe probleme të zhvillimit të terminologjisë se mekanikës teorike*" në Seminar i VI- të i Albanologjisë, 20-23 shtator 2012, Tetovë-Shkup 2012.

Pllana, G.: “*Standardizimi i terminologjisë së inxhinierisë mekanike në gjuhën shqipe nevojë e kohës*”, në ALBANOLOGJIA International Journal of Albanology, Vol.1, No:1-2/2014, UDK:81, USHT Tetovë, 2014.

Pllana, G.:” *The study of mechanic’s terminology in Albanian language (On the level of general terminology and a comprehensive special subfield)* “, SLATE 2015 Proceedings The Asian Conference on Second Language Acquisition and Teacher Education, August 2-4, 2015, Hiroshima, Japoni.

Pllana, G.: “*Procese të terminologjizimit në gjuhë*”, QSA IGJL “KËRKIME GJUHËSORE IV” KONFERENCE SHKENCORE NDËRKOMBËTARE, Tiranë, 10 korrik 2015.

Veselaj, N.: “*Çështje të shqipes standarde në fushë të normëzimit*”, Era, Prishtinë, 2015.